



QENDRA KOMBETARE E REHABILITIMIT TE TE VERBERVE
SHOQATA E TE VERBERVE TE SHQIPERISE

PERMBLEDHJE

LIGJESH, VENDIMESH DHE
UDHEZIMESH

PER TE VERBERIT.

Tirane 2007

Pergatiten botimin:

Dr. Av. Sinan Tafaj - President i Shoqates se te Verberve te Shqiperise
Av. Bujar Xhafa - Drejtor i departamentit te Asistences dhe Menaxhimit te QKRV

Botimi i kesaj permbledhje u financua nga:

Qendra Kombetare e Rehabilitimit te te Verberve,
Shoqata e te Verberve te Shqiperise.
Rruga "Nikolla Leno" nr. 62, Tirane. Tel: + 355 4 259 636, Tel/fax: + 355 4 259 611

PARATHENIE

Shoqata e te Verberve te Shqiperise dhe Qendra Kombetare e Rehabilitimit te te Verbrve nisur nga fakti qe kuadri ligjor mbi personat e verber në Shqipëri, nuk është plotësisht i njohur nga kjo kategori sociale, është tepër i shpërndarë dhe ka ndryshuar apo është pasuruar akoma edhe më shumë gjatë këtyre viteve, ndërmori nismën për botimin e përditësuar të kësaj përmbledhje te ligjeve, vendimeve dhe udhezimeve mbi personat e verber. Eshte hera e pare qe i gjithe legjislacioni per te verberit permblidhet ne nje botim te vetem dhe te plote.

Me kete botim synohet qe tu vihet ne ndihme ne radhe te pare qytetareve te verber, per njohjen dhe familjarizimin e me kuadrin ligjor mbi te drejtat e perfitimet e tyre si dhe, per te mundesuar marrjen e mendimeve te tyre per permisimimet qe duhet ti paraqiteten organeve perkatese per kete kuader ligjore.

Botimi do tu vije ne ndihme gjithashtu punonjesve qe punojne ne administraten e degeve te SHVSH ne rrethe, punonjesve e specialisteve te institucioneve qe ofrojne sherbime per te verberit, per njohjen me mire te te drejtave te personave te verber dhe ofrimit te sherbimeve te specializuara per kete komunitet.

Permbledhja e ligjeve, vendimeve dhe udhezimeve per te verberit eshte e ndare ne dy pjese. Ne pjesen e pare eshte perfshire i gjithe legjislacioni ne fuqi mbi te drejtat e qytetareve te verber, i azhornuar deri ne ditën e botimit, ndersa ne pjesen e dyte eshte perfshire kuadri ligjore i funksionimit te Shoqates se te Verberve te Shqiperise, degeve te saj ne rrethe si dhe Qendres Kombetare te Rehabilitimit te te Verberve.

Me perjashtim te ligjit “Per statusin e te verberit”, per ligjet e tjera te perfshira ne kete permbledhje jane botuar vetem ato kapituj apo nene qe lidhen me te drejtat e personave te verber, ndersa Vendimet dhe Udhezimet jane botuar te plota dhe permbajne te gjitha ndryshimet e bera ne to deri ne ditën e botimit te permbledhjes.

Per lehtësi ne perdorim, renditja e ligjeve, vendimeve te qeverise dhe udhezimeve eshte bere sipas natyres dhe llojit te problemit qe kane per objekt. Per shembull: pas ligjit nr. 9232 “Per programet sociale per strehimin e banoreve te zonave urbane” eshte vendosur vendimi perkates i Keshillit te Ministrave qe lidhet me dokumentacionin qe duhet te paraqesin te interesuarit per te perfituar nga ky ligj, pas VKM nr. 83, date 26.2.2001 “Per tarifate telefonike dhe per pagesat elektrike nga personat me aftesi te kufizuar” eshte vendosur Udhezimi perkates i ministrive te linjes ne te cilin jepen procedurat qe do te ndiqen per realizimin e ketij perfitimi.

Ne pjesen e dyte ku perfshihen aktet normative te SHVSH-se dhe te QKRV-se, renditja eshte bere sipas rendesise se aktit.

Ne kete permbledhje te interesuarit do te gjejne gjithçka qe do tu duhet lidhur me te drejtat e posaçme te te verberve dhe menyren e mbrojtjes dhe realizimit te tyre.

KOMENT I SHKURTER MBI LEGJISLACIONIN PER TE VERBERIT

Nevoja e ekzistences se nje legjislacioni te posaçem per te verberit.

- **Historik i shkurter.**

Komuniteti i te verberve ne Shqiperi qe ne momentin e pare te organizimit te tij u motivua nga mbrojtja e te drejtave te posaçme te anetareve te tij. Sigurisht qe ne ate kohe, shkalla e ndergjegjesimit nuk ishte ajo e sotnja por, ne menyre instiktive parandjeheshin veshtiresi e pasoja te paparashikueshme per te gjithë qytetaret e verber. Aso kohe as drejtuesit kryesore te ketij komuniteti nuk e kishin te qarte se te verberit duhet dhe meritonin nje legjislacion te posaçem sikunder edhe homologet e tyre neper bote, megjithate, per ta ishte e qarte se interesat dhe problemet e te verberve nuk gjendeshin dhe nuk gjenin zgjidhje ne politikat, trajtimet apo ligjet e pergjithshme. Nisur pikerisht nga keto rrethana, u synua nxjerrja e akteve ligjore dhe nenligjore te posaçme. Ndjeshmeria ndaj problemeve te komunitetit ishte kaq e larte sa nje jave pas themelimit te Shoqates se te Verberve te Shqiperise, 8 Janar 1991, ju parashtrua Presidentit te Republikes te asaj kohe, nevoja urgjente per nje mbeshtetje financiare per te gjithë te verberit qe ishin pa pune ose qe mund ta humbisnin ate. Iniciativa e personave te verber motivoi Presidentin qe ta shtrinte kete mbeshtetje edhe me tej duke perfshire te gjithë Personat me Aftesi te Kufizuar.

Hapi i dyte i rendesishem u be ne vitn 1992 kur Kryeministrin te asaj kohe ju paraqit projekt-vendimi i Keshillit te Ministrave per pagesat e verberise per te gjithë te verberit. Kjo u arrit me VKM nr. 164, date 19.04.1994, duke shtrire efektet nga 1 Janari i po atij viti. Ajo ishte nje arritje e madhe pasi, kjo pagese u shtri ne nje rreth te gjere dhe pa kufizime. Keto te drejta qe u arriten per te verberit u synuan edhe per kategori te tjera duke u realizuar ne gusht te vitit 1995.

Hapi i trete i madh dhe vendimtar i kesaj nisme ishte paraqitja e projekt-ligjit “Per statusin e te verberit” me Janar 1996. Me gjithë veshtiresite e medha per tu konceptuar dhe pranuar, ky projekt-ligj u shnderrua ne ligj pa asnje ndryshim me 28 Mars 1996. Objektivi per permiresimin cilesor te te drejtave te te verberve dhe mbrojtjes se tyre ka qene dhe mbetet e perhershme por, miratimi i ketij ligji, ishte nje kthese rrenjesore ne jeten e cdo qytetari te verber.

Kane kaluar 11 vjet dhe ne menyre te vazhdueshme po nga komuniteti i te verberve i jane paraqitur qeverise e parlamentit projekt-ligje dhe projekt-vendime ne zbatim e ne mbrojtje te interesave e te drejtave te qytetareve te verber.

Ky eshte nje proces normal por, ne momente te caktuara ai behet i rendesishem, i domosdoshem dhe pse jo edhe historik. Miratimi i ligjit nr. 9355, date 10.03.2005, “Per ndihmen ekonomike dhe sherbimet shoqerore” krijoi nje problem te madh ne zbatimin e ligjit “Per statusin e te verberve”, pasi si ligj kuader dhe i mevonshem interpretimet ishin ne favor te tij. Mirepo ligji nr. 9355, krijonte nje seri kufizimesh dhe mohonte te drejta qe me pare te verberit i kishin gezuar. Per kete arsye u be nje pune e madhe duke paraqitur nje projekt-ligj sipas te cilit te verberit perjashtoheshin nga ligji nr. 9355 dhe mbeteshin ne skemen e tyre te vecante sipas ligjit “per statusin e te verberit”. Pikerisht ky moment ka qene sa i rendesishem dhe historik per interesat dhe te drejtat e te verberve.

- **Perse nevojitet nje trajtim i veçante per te verberit.**

Per t'ju pergjigjur kesaj pyetje duhet ti referohemi perkufizimit per Aftesine e Kufizuar te bere ne Konventen e OKB-se per kete qellim si dhe te llogariten e perceptohen qarte pasojat e verberise.

Aftesia e kufizuar konceptohet si nje fenomen kompleks i perbere nga fenomenet mjeksore, shkencore si dhe ato shoqerore. Ndersa perceptimi i pare eshte i thjeshte, ai shoqeror eshte me i komplikuar. Thelbi i perceptimit shoqeror jane barrierat, raporti i individit me mjedisin natyror dhe shoqeror. Eshte e provuar shkencerisht se 90% e informacionit merret nepermjet shikimit, dhe po kaq eshte e provuar se shqisat e tjera mund te mbingarkohen ne funksion te zevendesimit te shqises se te parit, megjithate ne asnje rast dhe asnje here ky zevendesim nuk mund te jete i plote apo 100%.

Per te kuptuar kete do ti referohemi shkrimtarit te madh Erih Maria Remark i cili ka thene se: "Sikur njerezimi te kishte nje shqise te gjashte, jeta do te ishte ndryshe". Vehtevetiu dhe menjehere shtrohet pyetja "Po pa shqisen e te parit, si eshte jeta?". Sigurisht qe pergjigja eshte, NDRYSHE. Madje, krejt ndryshe. Ketu qendron thelbi apo strumbullari i te gjitha ceshtjes. Ndersa nje demtim fizik sjell nje kufizim nga jeta normale, verberia sjell nje jete krejt ndryshe, duke qene nje bote me vete. Ndersa demtimi apo kufizimi ne zhvillimin mendor ul sasine apo cilesine e te jetuarit normal, verberia sjell nje jete ndryshe.

Po ku qendron ndryshimi. Per te kuptuar kete, le ti referohemi jetes normale apo te perdritshme. Njerezit pa demtime apo kufizime kane ndertuar nje infrastrukture te plote per te gezuar dhe shijuar jeten e tyre duke filluar nga te shkruarit e te lexuarit, nga kompjuteri, ndriçimi ne erresire, makinat dhe autostradat, trenat dhe hekurudhat, avionet dhe aeroportet. E gjithë kjo infrastrukture gezohet dhe shfrytezohet mbi bazen e potencialeve qe jep shikimi dhe per te njejten arsye nuk mund te shfrytezohet nga te verberit. Nje infrastrukture e tille nuk ekziston per te verberit por, duke u nisur nga parimi i kompensimit shqisor, atyre mund tu ndertohet nje infrastrukture e posaçme e cila mund te perdoret me ndihmen e shqisave te tjera. Ketu fillon dhe behet e qarte se kostoja qe sjell verberia eshte absolutisht e pakrahasueshme me koston e kategorive te tjera te aftesise se kufizuar. Problematika e integritimit shoqeror eshte tejet e komplikuar, krahasuar me komunitetet e tjera, dhe e gjithë kjo kerkon nje vemendje dhe kujdes te posaçem dhe per pasoje nje rregullim juridik te veçante te ketij minigrupi marredheniesh shoqerore qe i bashkon i njejti kufizim dhe te njejtat pasoja.

Ne te gjitha konventat kryesore, perfshire edhe ate te Aftesise se Kufizuar, personaliteti dhe dinjiteti perkufizohen si te drejta te lindura se bashku me njeriun. E drejta e informimit eshte nje e drejte shoqerore qe vepron kryesisht ne fushen e marredhenieve me administraten publike dhe kohet e fundit eshte shenderruar si nje e drejte kushtetuese. Tashme ka ardhur koha te shtrohet pyetja: **"Po e drejta e informimit per mjedisin natyror dhe shoqeror, a duhet te konsiderohet si nje e drejte e lindur?"**

Komuniteti European dhe Boteror i te verberve eshte duke punuar per kete qellim.

- **Koment i pergjithshem mbi ligjin nr. 8098, date 28.03.1996, “Per statusin e te verberit”**

Subjekti i ligjit nr. 8098, date 28.03.1996, “Per statusin e te verberit” eshte qytetari i cili ka humbur shikimin ne ate mase qe eshte i paafte per pune ne kushte normale. Sipas ketij ligji perfituesit ndahen ne dy kategori:

- Grupi i pare- qe ka nevojte per te levizur me shoqerues.
- Grupi i dyte- qe nuk e ka nje nevojte te tille.

Fusha e veprimit te ketij ligji shtrihet thujse ne te gjitha drejtimet kryesore te jetes njezore. Keshtu, perfituesve ju sigurohet nje standart ekonomik i caktuar sic jane: pagesa e verberise, pagesa e kujdestarit, reduktimi i pageses mujore te energjise elektrike ne 20%, tarifa preferenciale telefonike, perjashtimi nga taksat e drejteperdrejta dhe tatimet, hyrja falas ne kinema, teater e stadiume, udhetimi urban falas dhe ai interurban me gjysem cmimi, perfitimi i nje pagese papunesie etj.

Nje grup te drejtash qe perfitohen jane edhe ato qe lidhen me te drejtat e njeriut. Keshtu dinjiteti i qytetarit te verber mbrohet ne menyre te posaqme duke ndaluar fyerjen, talljen si dhe te drejten e kallezimit penal per kujdestarin apo organizatat ku ai ben pjese. Ligji garanton mbrojtjen e te dhenave konfidenciale qe organizatat apo institucionet mund te disponojne per shkak te natyres se sherbimeve.

Po ne kete kuader, qytetarit te verber i garantohen favore proceduriale gjate procesit te gjykimit te padive apo kallezimeve qe ai mund te beje ne rastin e shkeljes se te drejtave te posaqme, sic eshte gjykimi pershpjtuar dhe shpenzime gjyqesore falas.

Nje grup tjetere te te drejtave jane ato te mbrojtjes se shendetit dhe mundesise se zhvillimit. Keshtu, krijohen kushte dhe rrethana te veqanta per mbrojtjen dhe permiresimin e shikimit, sigurimi shendetesor falas si dhe ilaqet apo pajisjet e posaqme me cmim te reduktuar.

Nje nen i posaqem i kushtohet edhe arsimimit te te verberve i cili garantohet falas ne arsimin publik, pranimi ne te behet me kritere te veqanta dhe motivohet me pagesa suplementare ndjekja e tij si dhe perfshirja ne studime pasuniversitare apo ne pune shkencore.

Ligji siguron gjithashtu realizimin e te drejtave qe lidhen me jeten e perditshme dhe autonome ne levizje. Ai ka percaktuar detyrimin per organet kompetente per eleminimin e barrierave, pershtatjen e infrastruktures publike ne menyre te tille qe te gezohet edhe nga qytetaret e verber. Nje pershtatje e tille shtrihet deri edhe ne banesen e tij duke e favorizuar me nje dhome shtese mbi kubaturen normale.

Cilat jane disa nga problemet qe ndeshen ne praktike ne zbatimin e ligjeve te kesaj natyre.

1. Ne llojin e vet dhe per nga fusha ku vepron, ligji “Per statusin ete verberit” ngjan me ligjet kuader pasi rregullon marrdhenie shoqerore specifike. Mirepo ndryshe nga ligjet kuader qe rregullojne ne themel marrdheniet e fushes ku veprojne, keto lloj ligjesh, sic eshte dhe ligji “Per statusin e te verberit”, bejne percaktime dhe favore deri ne kuadrin e te drejtave specifike ne te gjitha fushat e jetes, te cilat ne kuptimin e pergjithshem rregullohen me ligje te tjera. Ne keto rrethana, administrates publike i duhet ta kuptoje dhe ta trajtoje kete ligj, si nje ligj kuader qe vepron per kete rast te veqante. Realiteti tregon diqka krejt tjetere, pasi administrata publike ne qdo sector ku vepron, njeh si ligj

baze ligjin e pergjithshem ose ligjin kuader qe rregullon fushen ku ai e ushtron veprimtarine. Konkretisht, administrata e Ministrise se Arsimit kur eshte fjala per pranimin ne shkollat e mesme apo te larta, njeh dhe zbaton vetem ligjet per arsimin e mesem apo per ate te larte dhe injoron faktin se ne nenin 8 te ligjit "Per statusin e te verberit", Ministria e Arsimit eshte e ngarkuar te percaktoje kriteret e veçanta per pranimin e nxenesve apo studenteve te verber ne shkollat perkatese.

2. Ndryshe nga Kodet qe rregullojne te drejten materiale dhe qe shoqerohen me Kodet Procedurale, zbatimi i ligjit per te verberit varet nga dalja e akteve nenligjore, vendimeve te qeverise apo udhezimeve te ministrive. Veshtiresia qendron ne faktin se, tendenca e administrates eshte te kufizojte sa te jete e mundur pasojat dhe shpenzimet. Keshtu qe, ne nje mase te konsiderueshme, zbatimi i plote i ligjit varet edhe nga hapesirat qe krijojne aktet nenligjore. Per shembull, ne nenin 4, te ligjit "Per statusin e te verberit" thuhet se te verberit perjashtohen nga çdo lloj takse apo tatimi te drejteperdrejte, me perjashtim te rasteve kur ata perfshihen ne veprimtari biznesi si persona juridike.

Ne lidhje me kete çështje, kane qene dhe mbeten te diskutueshme te gjitha udhezimet e nxjerra nga Ministria e Financave ne lidhje me taksat dhe tatimet.

PERMBAJTJA

1. Strategjia Kombetare e Personave me Aftesi te Kufizuar.
2. Ligji nr. 8098, date 28.3.1996 “Per statsin e te verberit”.
3. Ligji nr. 9602, date 28.7.2006 “Per disa ndryshime ne ligjin nr. 9355, date 10.3.2005 “per ndihmen dhe sherbimet shoqerore”.
4. Ligji nr. 7995, date 20.9.1995 “Per nxitjen e punesimit”.
5. Ligji nr. 9232, date 13.5.2004 “Per programet sociale per strehimin e banoreve te zonave urbane”.
6. VKM nr. 53, date 28.1.2005 “Per percaktimin e dokumentacionit te nevojshem, afateve dhe procedurave per te perfutuar strehim nga programet e banesave sociale me qira”
7. Ligji nr. 7952, date 21.6.1995 “Per sistemin arsimor parauniversitar”.
8. Dispozita normative (Per shkollat publike).
9. VKM nr. 198, date 5.4.2006 “Per pranimet ne Universitetet dhe Shkollat e Larta, per vitin akademik 2006-2007, ne sistemin me kohe te plote dhe per percaktimin e tarifese shkollimit”.
10. VKM nr. 277, date 18.6.1997 “Per perfitimet nga statusi i te verberit”, i ndryshuar.
11. Udhezimi nr. 1766/1, date 17.09.2003 “Per zbatimin e VKM nr. 277, date 28.6.1997 “Per perfitimet nga statusi i te verberit”, i ndryshuar.
12. Udhezimi nr. 1956, date 19.9.2006 “Per nje ndryshim ne Udhezimin e ministrit te Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta nr. 1281, date 15.7.2004 “Per disa ndryshime ne udhezimin nr.1766/1,date 17.9.2003 “Per zbatimin e e vendimit te Kshillit te Ministrave nr. 277, date 18.6.1997 “Per perfitimet nga statusii te verberit”.
13. VKM nr. 671, date 15.12.2000 “Per krijimin e Komisionit mjeksore te percaktimit te verberise”.
14. Udhezim nr. 74 date 11.01.2002 “Mbi zbatimin e VKM nr. 74, date 15.12.2000, “Per krijimin e Komisionit mjeksor te Percaktimi te verberise”
15. VKM nr. 83, date 26.2.2001“Per tarifate telefonike dhe per pagesat elektrike nga Personat me aftesi te kufizuar”, i ndryshuar.
16. Udhezimi i ministrise se Industrise dhe Energjetikes, ministries se Shendetsise, ministries se Punes dhe Ceshtjeve Sociale “Per perfitimet ne Pagesen e energjise elektrike te personave me aftesi te kufizuar.
17. Udhezimi i ministrise se Financave nr.1, date 30.1.2006 “Per sistemin e taksave Kombetare ne Republiken e Shqiperise”.

18. Statuti i Shoqates se te Verberve te Shqiperise
19. Rregullorja e funksionimit te degeve te SHV
20. Rregullore e brendshme per funksionimin dhe administrimin e QKRV
21. Rregullorja mbi qarullimin e mjeteve monetare dhe materiale
22. Udhezimi i Presidentit te SHVSH "Per te gjithë perfituesit mbajtes te librezes se verberise"